



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.157/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Ramush Bardiqi - kryesues, Bujar Muzaqi dhe Hajriz Hoti - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë kundër subjektit politik Partija Kosovskih Srba (PKS), me seli në Mitrovicën e Veriut, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025, në seancën e panelit të mbajtur me 25.01.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohen të bazuara ankesat e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, Anr.157/2025, Anr.161/2025 dhe Anr.162/2025 e datës 23.01.2025, ashtu që subjektit politik Partija Kosovskih Srba (PKS), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjohë në lartësi prej 3,500.00 (tremijë e pesëqind) euro.

II. Detyrohet Subjekti politik Partija Kosovskih Srba (PKS), me seli në Mitrovicën e Veriut, që gjohën e shqiptuar si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datë 23.01.2025 PZAP-i, ka pranuar ankesat Anr.157/2025, Anr.161/2025 dhe Anr.162/2025 nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me të cilën pretendon se më datë 23.01.2025, aktivistë të Lëvizjes Vetëvendosje në Mitrovicën e Veriut kanë identifikuar banerët/posterët e vendosura në hapësirat/rrugët publike të subjektit politik, *Partija Kosovskih Srba PKS*, në ndërtesën publike në rrugën “Vlade Çetkoviça” në Mitrovicën e Veriut, në sheshin kryesor “Kral Petra” në Mitrovicën e Veriut, dhe në ndërtesat publike në rrugën “Kralja Petral” në Mitrovicën e Veriut.

Sipas parashtruesit të ankesave me këtë veprim subjekti politik PKS kanë bërë shkelje të nenit 34, paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës-LZP.

Si provë ka bashkangjitur, fotografi që dëshmon vendosjen e banerëve/posterëve me nr. 120, numri Identifikues i subjektit politik PKS, në kundërshtim me LZP.

Më datë 24.01.2025, PZAP-i, e njoftoi subjektin politik Partija Kosovskih Srba (PKS), për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje deri më 25.01.2025.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur me datë 25.01.2025, subjekti politik Partija Kosovskih Srba (PKS) ka kundërshtuar ankesën e paraqitur nga subjekti Lëvizja Vetëvendosje (LVV) lidhur me vendosjen e disa posterëve të subjektit të tyre në veri të Mitrovicës.

Në vazhdim të përgjigjes theksojnë se me keqardhje ju informojmë se nga viti 2017 nuk kanë pasur kapacitete njerëzore dhe teknike për të vendosur posterat e tyre dhe as për të zhvilluar një fushatë në veri të Mitrovicës dhe për fat të keq për ata, Mitrovica veriore ka qenë një “qytet i ndaluar” që nga viti 2017. Me tutje theksojnë se posterët që iu kanë bashkangjitur në ankesë e subjektit politik LVV janë 99% të ngjashëm në pamje dhe përmbajtje me posterët e tyre, por për fat të keq ju informojmë se në Mitrovicë nuk kanë mundur t'i sigurojnë as anëtarët e këshillave të vendvotimeve që ju ka dhënë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) dhe absolutisht nuk kanë të bëjnë me këto postera dhe as nuk kemi mundur të vendosim postera atje. Në përgjigjen e PKS-së, thuhet se nuk kanë kapacitete për ti bërë këto veprime dhe ndoshta e kanë bërë opsionet e tyre rivale, për të ju shkaktuar dëme financiare dhe për të provokuar qytetarët duke pasur postera "tyre" në hyrje e tyre. Subjekti politik PKS në përgjigjen e tyre e mohojnë plotësisht përgjegjësinë për këtë dhe nuk kanë pasur asnjë aktivitet parazgjedhor në Mitrovicë deri më tani dhe as nuk janë në gjendje ta organizojnë atë.

Paneli, në kuptim të nenit 9 paragrafi 5, nën paragrafi 5.5 të Rregullores Nr.01/2024, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka bashkuar ankesat A.nr.157/2025, A.nr.161 dhe A.nr.162/2025 të paraqitura me datë 23.01.2025, dhe janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjën e përbashkët A.nr.157/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve të parashtruara nga subjekti i njëjtë politik LVV kundër subjektit politik PKS, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankesave.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesat gjeti se:

Ankesat janë të bazuara

Paneli, nga fotografitë e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, të cilat gjenden në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë ka konstatuar se posterët/ banerët e subjektit politik, Partija Kosovskih Srba (PKS), kanë shfrytëzuar jashtëligjshëm dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore hapësirat publike konkretisht në ndërtesën publike në rrugën “Vlade Çetkoviça”, në sheshin kryesor “Kral Petra”, dhe në ndërtesat publike në rrugën “Kralja Petral” në Mitrovicën e Veriut, në kundërshtim me nenin 34, paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës LZP, konkretisht neni 34, paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i LZP-së parasheh: "1. *Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim:1.2*

vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose e sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare, ose brenda ose në hapësirat private pa leje e pronarëve ose shfrytëzuesve.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: “vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të qëndrueshme dhe si të tilla i pranoi, sepse kjo shkelje ka të bëjë me faktin se Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës demokratike, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit se nga veprimet e përshkruara në ankesë nga parashtruesi i ankesës paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtën e pranoi si të bazuar. Paneli ka shqyrtuar pretendimet në përgjigje në ankesë, mirëpo te njëjtat i ka refuzuar si të pabazuara, për arsye se, nga provat, përkatësisht fotografitë e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, të cilat gjenden në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë ka konstatuar se posterët/ banerët e subjektit politik, Partija Kosovskih Srba (PKS) nr 120 identifikues që shihet në fotograf i përkasin këtij subjekti politik.

Gjithashtu Paneli, me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes, dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, se ky veprim i tyre përbën përsëritje të shkeljes së legjislacionit zgjedhor, pra ka bërë shkelje të tilla edhe në proceset e mëparshme zgjedhore. Kjo konsiston në faktin se Subjekti Politik PKS, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës zgjedhore. Andaj përfshirja e posterëve të subjektit të tyre politik për fushatë zgjedhore në hapësira publike gjegjësisht në rrugët publike e lartcekura , përbën shkelje të legjislacionit zgjedhor, saktësisht e sanksionuar me dispozitën saktësisht e sanksionuar me dispozitën e nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar në nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 dhe neni 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së, të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.157/2025 më datë 25.01.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së.